




**PROCESI I MARRJES SË
MASAVE DISIPLINORE NDAJ GJYQTARËVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Manual për qytetarët

Kjo broshurë është ideuar për të njohur qytetarët me veprimtarinë e sistemit gjyqësor dhe për t'u shërbyer si udhërrëfyes për ta bërë sa më të lehtë dhe më produktiv përdorimin e këtij sistemi.

Fatmirësisht ekzistojnë pak rrethana ku gjyqtarët veprojnë jo ashtu siç duhet. Gjetja e metodave efektive dhe serioze për ndëshkrimin e atyre që nuk veprojnë siç duhet është shumë e rëndësishme për ruajtjen e besimit të opinionit publik në integritetin e gjyqtarëve dhe të gjithë procesit gjyqësor

VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM I PROCESIT DISIPLINOR NDAJ GJYQTARËVE



**Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.*

**PROCESI I ANKIMIT NDAJ NJË GJYQTARI
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:
MANUAL PËR QYTETARËT**

Përmbajtja:

Përpara se të përgatitësh një ankesë.....7

A kam të drejtë të ankojem ndaj një gjyqtari në Republikën e Shqipërisë? Nëse une ankojem, a do të merret në konsideratë ankesa ime? A ka afate në paraqitjen e një ankesë? Për çfarë mund të ankojem, cilat sjellje të gjyqtarit konsiderohen shkelje?

Ankesa.....9

Si mund të bëj unë një ankesë? Çfarë duhet të përmbajë ankesa? A duhet të identifikohem kur bëj një ankesë?

Zyra e Presidentit të Republikës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë.....11

Ku duhet ta paraqesë një ankesë? Çfarë bën Zyra e Presidentit të Republikës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë me marrjen e një ankesë? A janë ankesat konfidenciale? A merr dijeni gjyqtari për ankesën? A janë procedurat të hapura për publikun? Sa kohë zgjat procedura ankimore deri në marrjen e vendimit? A kam të drejtë të ankojem nëse ankimi im nuk merret në konsideratë dhe nëse kërkesa pranohet a joftohet?

Këshilli i Lartë i Drejtësisë.....14

Përbërja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Çfarë procedure ndiqet që një ankesë të shqyrtohet nga KLD-ja? A janë procedurat e KLD-së të hapura për publikun? Nëse unë ankojem, a do të dal përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë të dëgjohem? A do të dëgjohet gjyqtari ndaj të cilit jam ankuar? Çfarë masash disiplinore merren ndaj gjyqtarit?

Ankimi ndaj një vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....17

A mundet një gjyqtar të ankimojë një masë disiplinore? A mund të ankojem nëse KLD-ja nuk merr masë disiplinore? Cili është roli i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës Kushtetuese në procesin disiplinor ndaj një gjyqtari?

PËRPARA SE TË PËRGATITËSH NJË ANKESË

A kam të drejtë të ankoem ndaj një gjyqtari në Republikën e Shqipërisë?

Po, ke të drejtë të ankohesh. Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1998 parashikon të drejtën e qytetarëve për të bërë ankesë si një nga të drejtat themelore.

Kjo e drejtë është sanksionuar në nenin 48 të Kushtetutës, ku parashikohet shprehimisht se:

“Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj”.

Një qytetar mund të ankohet ndaj gjyqtarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe ndaj gjyqtarëve të gjykatave të apelit.

Nëse unë ankoem, a do të merret në konsideratë ankesa ime?

Jo të gjitha ankesat do të merren në konsideratë.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë verifikon ose i dërgon Ministrin të Drejtësisë për trajtim ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Verifikon ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar Ministrin të Drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij për t’u ndjekur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

A ka afate në paraqitjen e një ankese?

Po ka afate. Paraqitja e ankesës, fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet brenda tre viteve nga data e kryerjes së shkeljes.

Për çfarë mund të ankohe, cilat sjellje të gjyqtarit konsiderohen shkelje?

Gjyqtarët kanë përgjegjësi për shkelje të disiplinës si dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskretitojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë.

Konsiderohen shkelje të disiplinës:

1. kryerja e veprimeve që sipas ligjit janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit;
2. nxjerrja e sekretit të hetimit, të dhomës së këshillimit ose të të dhënave të tjera me karakter intim;
3. zvarritje të rënda ose sistematike në kryerjen e detyrës;
4. mosrespektimi i rregullave të solemnitetit;
5. mungesa pa arsye në punë;
6. kryerja e veprimeve të pahijshme ose amorale brenda dhe jashtë kohës së punës;
7. kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale, kur nuk përbën vepër penale;
8. moszbatim pa arsye i masës disiplinore.

ANKESA

Si mund të bëjë unë një ankesë?

Kushdo mund të bëjë një ankim falas. Nuk është e nevojshme asistenca e një avokati apo juristi në bërjen e një ankesë ndaj një gjyqtari. Ankesat duhet të bëhen me shkrim në adresat e mëposhtme:

Ministria e Drejtësisë (Adr: Blv. "Zogu I")
Keshilli i Lartë i Drejtësisë (Adr: Blv. "Zogu I")
Presidenca (Adr: Blv. "Dëshmorët e Kombit")
Avokati i Popullit (Adr: Blv. "Zhan D'Ark")

Ankesat mund të postohen nëpërmjet shërbimit postar ose të dorëzohen në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Drejtësisë, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Presidencës.

Çfarë duhet të përmbajë ankesa?

Ankesa duhet të ketë të paktën elementet e mëposhtme, në mënyrë që të konsiderohet për verifikim:

a) Fakte apo rrethana që kanë të bëjnë me mosfunksionimin normal të zyrës së gjyqtarit.

b) Fakte apo rrethana që mund të konsiderohen shkelje në referim të detyrave gjyqësore të gjyqtarit, të cilat, përgjithësisht, kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit, me mosrespektimin e solemnitetit gjatë gjykimit, me planifikimin dhe organizimin e punës, si dhe me sjelljen e gjyqtarit gjatë apo jashtë gjykimit, që, nga ana tjetër, kanë

ndikuar apo tregojnë dukshëm për zvarritje të pajustificuar të procesit.

c) Fakte apo rrethana që mund të konsiderohen shkelje në referim të normave të sjelljes dhe etikës së gjyqtarit.

A duhet të identifikohem kur bëj një ankesë?

Nuk është detyrim identifikimi, por është e rekomandueshme për një punë më efikase në verifikimin e rastit konkret.

**ZYRA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS,
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË DHE
MINISTRIA E DREJTËSISË**

Ku duhet ta paraqesë një ankesë?

Në Shqipëri, ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit mund të paraqiten përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyra e Presidentit të Republikës.

Çfarë bën Zyra e Presidentit të Republikës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë me marrjen e një ankese?

Ankesat e paraqitura tek zyra e Presidentit të Republikës pasi shqyrtohen, sipas rastit dërgohen për verifikim pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me marrjen e një ankese, Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Inspektoratit të saj kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. Përveç inspektimit tematik të përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë kryen edhe inspektime të veçanta lidhur me procedimin disiplinor të gjyqtarëve, në bazë të ankesave të marra nga qytetarët dhe institucionet e tjera.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë verifikon ose i dërgon Ministrinë të Drejtësisë për trajtim ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Verifikon ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar Ministrinë të Drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij për t'u ndjekur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ankesat e depozituara, si dhe ato të bëra publike nëpërmjet medias, regjistrohen në Regjistrin e Ankesave. Ankesa ndjek procesin e shqyrtimit të saj, të vlerësimit dhe nëse është rasti propozimin e masës disiplinore.

A janë ankesat konfidenciale?

Ankesat dhe dokumentacioni përkatës janë konfidenciale për aq sa janë në përputhje me ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, me ligjin nr. 8457, datë 11.12.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” dhe me ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

A merr dijëni gjyqtari për ankesën?

Po. Verifikimi i ankesave dhe inspektimi i gjyqtarit bëhet vetëm pasi ky i fundit të jetë vënë paraprakisht në dijeni.

Gjyqtari i proceduar ka të drejtë të njihet me dokumentacionin e procedimit. Marrja dijëni vërtetohet nëpërmjet nënshkrimit të deklaramentit përkatës nga gjyqtari i proceduar dhe nga inspektori. Në rast se gjyqtari nuk pranohet të nënshkruajë ose nuk gjendet, materialet i bëhen të ditura kryetarit të gjykatës, kundrejt nënshkrimit të këtij të fundit

A janë procedurat të hapura për publikun?

Publiku ka të drejtë të marrë informacion në lidhje me ecurinë e procesit të shqyrtimit të një ankesë, por nuk është palë në proces dhe si i tillë nuk mund të marrë pjesë në procedurë.

Sa kohë zgjat procedura ankimore deri në marrjen e vendimit?

Nuk ka një afat konkret, por sidoqoftë procedura zhvillohet brenda afatit trevjeçar të parashkrimit.

A kam të drejtë të ankohe nëse ankimi im nuk merret në konsideratë dhe nëse kërkesa pranohet a njoftohet?

Me marrjen e ankesave si Këshilli i Lartë i Drejtësisë ashtu edhe Ministria e Drejtësisë bëjnë një vlerësim të ankesës sipas kriterëve të përcaktuara në ligj dhe akte të tjera nënligjore. Në rastin kur ankesa nuk vlerësohet se përbën objekt për investigim të mëtejshëm ankuesit i kthehet një përgjigje ku jepen edhe arsyet e mospranimit. Në këtë rast ankuesi nuk ka të drejtë të ankohet për mospranimin e ankesës.

Në rastin kur ankesa pranohet ankuesi ka të drejtë të informohet mbi ecurinë e procesit si dhe me përfundimin e tij.

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Cila është përbërja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë?

Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Çfarë procedure ndiqet që një ankesë të shqyrtohet nga KLD-ja?

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur ngarkohet me detyra verifikuese, është i detyruar që, brenda 15 ditëve, të kryej procedurat e verifikimit dhe të depozitojë raportin përkatës.

Ministri i Drejtësisë kryen inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit për organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, si dhe realizon e vendos për procedimin disiplinor të gjyqtarëve të tyre.

Ministri i Drejtësisë kryen inspektime sipas programeve të posaçme tematike ose territoriale, të hartuara kryesisht ose në zbatim të detyrave të caktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vijim të procesit të verifikimit të ankesave të shtetasve dhe të subjekteve juridike, si dhe sipas të dhënave, për të cilat vihet në dijeni kryesisht ose nëpërmjet Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe depoziton dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Lartë

të Drejtësisë.

Kërkesa për procedimin disiplinor, përveç dokumentacionit me të dhënat përkatëse, të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, përmban edhe propozimin për llojin e masës disiplinore që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit të proceduar disiplinarisht.

Ministri i Drejtësisë vë në dijeni Këshillin e Lartë të Drejtësisë për rastet dhe për motivet e mosfillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit në kushtet e shkronjës “a” pika 1 të nenit 16 të ligjit për “Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”

Në çdo rast, në përfundim të procesit të verifikimit ose të inspektimit, Ministri i Drejtësisë ose Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet t’i kërkojnë gjyqtarit që procedohet, që të paraqesë me shkrim pretendimet e tij të cilat janë të detyruar t’i pasqyrojnë në dokumentacionin përfundimtar.

Nëse une ankoem, a do të thirrem dhe të dëgjoem për pretendimet e mia përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë?

Jo. Nuk do të thirresh për t’u dëgjuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

A do të dëgjoet gjyqtari ndaj të cilit jam ankuar?

Po. Në çdo rast duhet të dëgjoet edhe gjyqtari që ka kryer shkeljen. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përpara se të marrë vendimin duhet të dëgjojë pretendimet e palëve. Gjyqtari që procedohet ka të drejtë të mbrohet vetë ose në prani të një avokati gjatë seancës.

Përgjithësisht gjyqtarët kanë qenë të pranishëm në mbledhje me prezencën e një avokati.

Kur mund të shkarkohet një gjyqtar dhe çfarë masash disiplinore merren ndaj gjyqtarit?

Sipas nenit 147, pika 6, të Kushtetutës, gjyqtari mund të shkarkohet nga KLD për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore apo fizike, për akte që diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale.

Për shkelje të disiplinës, si dhe akte dhe sjellje të tjera diskretituese, masat që Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të marrë për një gjyqtar janë:

1. Vërejtje.
2. Vërejtje me paralajmërim.
3. Pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës për një periudhë nga 6 muaj deri në 1 vit.
4. Transferim në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët.
5. Shkarkim nga detyra.

ANKIMI NDAJ NJË VENDIMI TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

A mundet një gjyqtar të ankimojë një masë disiplinore?

Ankimi ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit, si dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor bëhet nga vetë gjyqtari në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjykimi i çështjes bëhet nga Kolegjet e Bashkuara.

Kryetari ose gjyqtarët e Gjykatës së Lartë të cilët, në cilësinë e tyre si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kanë marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ku u mor masa disiplinore ndaj ankuesit, nuk marrin pjesë në trupin gjykues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

A mund të ankohe nëse KLD nuk merr masë disiplinore?

Jo, nuk mund të ankohe

Cili është roli i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës Kushtetuese në procesin disiplinor ndaj një gjyqtari?

Pranë Gjykatës së Lartë mund të bëhet ankim nga gjyqtari në rast se ndaj tij është marrë masë për shkarkimin nga detyra nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese, me investimin e gjyqatrit, mund të vihet në lëvizje vetëm nëse gjatë procesit të dhënies së masës disiplinore, çënohen procedura të cilat çënojnë parimin e një procesi të rregullt gjyqësor.